



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE**  
**DEPARTAMENTI I ENERJITIKËS**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 23.06.2021

**Lënda:** *Kërkesë për hapjen e kursit të formimit të vazhduar “Auditim Energjie”, drejtim i dytë “AE në Procese”*

**Drejtuar:** **Dekanit të FIM**

Sic jeni në dijeni, pranë Departamentit të Energjitikës gjatë periudhës Janar – Qershor 2021 ka përfunduar kursi i formimit të vazhduar “Auditim Energjie” në dy drejtime: “AE në Ndërtesa” dhe “AE në Procese”.

Meqënëse disa nga kursantët që kanë përfunduar profilin “AE në Ndërtesa” dëshirojnë të ndjekin edhe profilin e dytë, propozojmë hapjen e kursit për drejtimin e dytë “AE në Procese” me 8 kredite ECTS, meqënëse 13 kredite ECTS janë të pjesës së përgatitjes së përbashkët.

Propozojmë që aplikimet të jenë të hapura deri në datë 30.06.2021 dhe kursi të fillojë në datë 02.07.2021.

Aplikimet për ndjekjen e këtij programi studimi të bëhen pranë: Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike nga data 24.06.2021 deri në datë 30.06.2021, cdo ditë pune nga ora 12<sup>00</sup>-16<sup>00</sup>.

Kordinator i miratuar i këtij kursi është Dr. Ardit GJETA.

Dokumentat që duhen paraqitur:

1. Formular aplikimi (modeli bashkëngjitur) dhe dokumenta të tjera plotësuese nëse kursi “Auditim Energjie në Ndërtesa” nuk është kryer pranë FIM;
2. Mandat-pagesa 1000 (njëmijë) Lekë për regjistrim.

Dokumentat e tjera (Diploma, kartë identiteti, dëshmi të ndryshme) janë në dosjet e aplikantëve nga kursi i mëparshëm që kanë ndjekur.

Ju lutemi të bëni njoftimet përkatëse për të interesuarit.

DREJTUES DEPARTAMENTI

**Prof. Asoc. Majlinda ALCANI**